



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 73

Tiranë – E hënë, 16 maj 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13608, datë 10.5.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 29.4.2022	Për njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), që do të përdoren në Shqipëri, njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shtesë të vendosura ndërkombëtarisht dhe mënyra e përdorimit të tyre..... 9315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 296, datë 11.5.2022	Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (Agjencia e Zbatimit të Projektit), masat shoqëruese për rehabilitimin e Hidrocentralit të Fierzës..... 9322
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 5, datë 21.3.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit..... 9330
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 6, datë 23.3. 2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit..... 9331
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 7, datë 25.3.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit..... 9331

Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 8, datë 29.3.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9332
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 9, datë 31.3.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9332
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 10, datë 1.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9333
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 11, datë 5.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9333
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 12, datë 6.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9334
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 13, datë 6.4.2022	Për pezullim licence për 3 muaj për ushtrim veprimtarie dhe detyrimin për mosndryshimin e gjendjes së produkteve të naftës dhe të gazit, subjektit “Bregu Oil” sh.p.k.....	9334
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 14, datë 8.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9335

Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 15, datë 13.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9335
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 16, datë 15.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9336
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 17, datë 23.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9336
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 18, datë 26.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9337
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 19, datë 27.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9338
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 20, datë 29.4.2022	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	9338
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 10, datë 6.5.2022	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	9339
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 246/4, datë 11.5.2022	Për shpronësim për disa shtesa në vendimin nr. 657, datë 8.10.2014, “Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti ‘Ndërtimi i segmentit rrugor Qukës–Qafëpulloçë’”.....	9341



DEKRET

Nr. 13608, datë 10.5.2022

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Gesana Spiro Fani (Visho)
2. Gentian Jani Fani
3. Moira Gentian Fani
4. Erion Istref Ymeraj
5. Odrin Erion Ymeraj
6. Resmi Dëfrim Mirashi
7. Shpresa Skënder Qirjo (Gjoni)
8. Juliana Sotir Qirjo
9. Enea Petraq Koçi
10. Rebeka Preng Ndoj
11. Redian Mehmet Hoxha
12. Miriam Kurt Schenk (Xhepa)
13. Genti Agron Salu
14. Mersi Arben Stafa
15. Ershela Shpëtim Kazazi
16. Ervin Atnant Çiku
17. Vasil Dhimitri Lloli
18. Albana Luan Idrizaj
19. Alda Koli Daka
20. Besmir Muhamet Cegrani
21. Erzen Foto Uruçi
22. Kaltrina Erzen Uruçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 261, datë 29.4.2022

PËR NJËSITË BAZË TË SISTEMIT
NDËRKOMBËTAR TË NJËSIVE (SI),
QË DO TË PËRDOREN NË SHQIPËRI,
NJËSITË QË RRJEDHIN PREJ TYRE,
SHUMËFISHAT DHE NËNFISHAT,
NJËSITË SHITESË TË VENDOSURA
NDËRKOMBËTARISHT DHE MËNYRA
E PËRDORIMIT TË TYRE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 126/2020, “Për metrologjinë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Republikën e Shqipërisë përdoren njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), njësitë që rrjedhin prej tyre, shumëfishat dhe nënfishat, njësitë shitesë të vendosura ndërkombëtarisht, të përcaktuara në këtë vendim.

2. Mënyra e përdorimit të njësive të matjes, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përcaktohet në këtë vendim.

3. Në transportin ajror, detar dhe hekurudhor, krahas njësive të sistemit SI të paraqitura në këtë vendim, lejohen të përdoren edhe njësi të tjera të përcaktuara në konventa apo marrëveshje ndërkombëtare të këtyre llojeve të transporteve.

4. Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), janë:

4.1 Njësia e kohës: sekondë, simboli s, është njësia SI e kohës. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të frekuencës së ceziumit $\Delta\nu_{Cs}$, frekuenca e tranzicionit në gjendjen themelore të atomit 133 të ceziumit, prej 9 192 631 770, kur shprehet në njësinë Hz, e cila është e barabartë me s⁻¹.

4.2 Njësia e gjatësisë: metër, simboli m, është njësia SI e gjatësisë. Ajo përcaktohet duke marrë

¹ Ky vendim përaftron pjesërisht direktivën e Komisionit (BE) 2019/1258, datë 23.7.2019, që amendon për qëllim përshtatjen me progresin teknik, aneksin e direktivës së Këshillit 80/181/KEE, në lidhje me përkufizimet e njësive bazë të SI. CELEX nr.32019L1258. Gazeta Zyrtare e BE-së, L 196, datë 24 korrik 2019.



vlerën fikse numerike të shpejtësisë së dritës në vakuum c prej $299\,792\,458$, kur shprehet në njësinë m/s , ku s përcaktohet në terma të $\Delta\nu_{Cs}$ -së.

4.3 Njësia e masës: kilogram, simboli kg , është njësia SI e masës. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të konstantës *Planck* h prej $6.626\,070\,15 \times 10^{-34}$, kur shprehet në njësinë $J \cdot s$, e cila është e barabartë me $kg \cdot m^2 \cdot s^{-1}$, ku metri dhe sekonda përcaktohen në terma të c -së dhe $\Delta\nu_{Cs}$ -së.

4.4 Njësia e rrymës elektrike: amper, simboli A , është njësia SI e rrymës elektrike. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të ngarkesës elementare prej $1,602\,176\,634 \times 10^{-19}$, kur shprehet në njësinë C , e cila është e barabartë me $A \cdot s$, ku sekonda përcaktohet në terma të $\Delta\nu_{Cs}$ -së.

4.5 Njësia e temperaturës termodinamike: kelvin, simboli K , është njësia SI e temperaturës termodinamike. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të konstantes *Boltzmann* k prej $1,380\,649 \times 10^{-23}$, kur shprehet në njësinë $J \cdot K^{-1}$, e cila është e barabartë me $kg \cdot m^2 \cdot s^{-2} \cdot K^{-1}$, ku kilogrami, metri dhe sekonda përcaktohen në terma të h -së, c -së dhe $\Delta\nu_{Cs}$ -së.

4.6 Njësia e sasisë së substancës: mol, simboli mol , është njësia SI e sasisë së substancës. Një mol përmban saktësisht $6,022\,140\,76 \times 10^{23}$ grimca elementare. Ky numër është vlera numerike e konstantes Avogadro, NA , kur shprehet në njësinë mol^{-1} dhe quhet numri i Avogadros.

Sasia e substancës, simboli n , i një sistemi është një masë e numrit të njësive themelore të specifikuara. Një grimcë elementare mund të jetë një atom, një molekulë, një jon, një elektron, çdo grimcë tjetër ose grup i caktuar grimcash.

4.7 Njësia e intensitetit të dritës: kandela, simboli cd , është njësia SI e intensitetit të dritës në një drejtim të caktuar. Ajo përcaktohet duke marrë vlerën fikse numerike të efikasitetit të dritës së rrezatimit monokromatik të frekuencës 540×10^{12} Hz, K_{cd} , prej 683 , kur shprehet në njësinë $lm \cdot W^{-1}$, e cila është e barabartë me $cdsr \cdot W^{-1}$, ose $cdsr \cdot kg^{-1} \cdot m^{-2} \cdot s^3$, ku kilogrami, metri dhe sekonda përcaktohen në terma të h -së, c -së dhe $\Delta\nu_{Cs}$ -së.

4.8 Madhësia, emri dhe simboli i njësive bazë SI jepen në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Madhësia, emri dhe simboli i njësive të

rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI). Njësitë e rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) formohen nga njësitë bazë nëpërmjet shprehjeve algjebrike, që lidhin madhësitë korresponduese.

5.1 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të cilat shprehen vetëm nga njësitë bazë të këtij sistemi matjeje, jepen në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.2 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të cilat shprehen me emra dhe simbole të veçanta jepen në tabelën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.3 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI), të cilat shprehen nga kombinimi i disa njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI me emra dhe simbole të veçanta, jepen në tabelën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Sistemi Ndërkombëtar i Njësive (SI) shpreh shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive të matjes me ndihmën e parashtesave. Faktori i fuqisë, emri dhe simboli i parashtesave të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) jepen në tabelën nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Emri, simboli dhe vlera në njësi SI e njësive të pranura për t'u përdorur me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) jepen në tabelën nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Emri, simboli, përkufizimi dhe vlera në njësi SI e njësive matëse të pranura për t'u përdorur në Sistemin Ndërkombëtar të Matjeve SI, vlera e të cilave është përcaktuar në mënyrë eksperimentale, jepen në tabelën nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Emri, simboli dhe vlera në njësi SI e njësive të tjera të pranura për t'u përdorur në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) jepen në tabelat nr. 8 (a), 8 (b) dhe 8 (c), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

10. Rregullat për përdorimin e drejtë të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive (SI) janë:

10.1 Çdo madhësi në Sistemin Ndërkombëtar të Njësive (SI) ka një njësi të vetme, ndërsa e anasjella nuk është e vërtetë.

10.2 Vlerat e madhësive të quajtura pa përmasa shprehen vetëm me numra dhe paraqesin raportin e dy madhësive të së njëjtës natyrë.



10.3 Simbolet e njësive shkruhen me shkronja latine dhe në përgjithësi të vogla.

Në rastet kur emri i njësisë rrjedh nga një emër i përveçëm, shkronja e parë e simbolit shkruhet me shkronjë të madhe.

10.4 Emri i plotë i një njësie shkruhet me shkronjë të vogël.

10.5 Simbolet e njësive mbeten të pandryshuara, kur vlera e madhësisë ndryshon nga njësia.

10.6 Simbolet e njësive nuk ndiqen me pikë pas tyre, me përjashtim të rasteve kur ndodhen në fund të fjalisë.

10.7 Nëse një njësi shoqërohet me madhësi relative, duhet që ajo të tregohet vetëm me simbolin e vendosur prapa vlerës numerike.

10.8 Produkti i dy ose më shumë njësive shënohet me njërën nga mënyrat e mëposhtme: N.m ose N m.

10.9 Kur një njësi e rrjedhur formohet nga pjesëtimi i dy njësive, përdoret një vijë e pjerrët (/), një vijë horizontale ose eksponentë negativë.

10.10 Asnjëherë nuk përdoret në një rresht më shumë se një vijë e pjerrët, me përjashtim të rastit kur janë vendosur kllapat.

10.11 Shumëfishat dhe nënfishat e njësisë së masës formohen nga bashkimi i parashtesave me fjalën “gram”, simboli i të cilit është “g”.

10.12 Simbolet e parashtesave shkruhen me shkronja latine, pa hapësirë ndërmjet simbolit të parashtesës dhe simbolit të njësisë.

10.14 Nuk lejohet të përdoren parashtesa të përbëra, të formuara nga vendosja e shumë parashtesave.

10.15 Një parashtesë nuk lejohet të përdoret vetëm, pa njësinë.

10.16 Nëse simbolit të njësisë të ngritur në një fuqi i vihet një parashtesë, atëherë edhe parashtesa kuptohet që është e ngritur në atë fuqi.

10.17 Nuk lejohet zbatimi i parashtesave SI për njësitë këndore: “, ‘, apo për njësitë e kohës: min, h, d.

11. Vendimi nr. 1162, datë 13.8.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Tabela nr. 1

NJËSITË BAZË SI

Madhësia	Njësia	
	Emri	Simboli
Koha	sekondë	s
Gjatësia	metër	m
Masa	kilogram	kg
Rryma elektrike	amper	A
Temperatura termodinamike	kelvin	K
Sasia e lëndës	mol	mol
Intensiteti i dritës	kandela	cd

Tabela nr. 1.1

Emri dhe simboli i veçantë i njësisë së temperaturës për shprehjen e temperaturës në Celsius.

Madhësia	Njësia	
	Emri	Simboli
Temperatura celsius	Celsius	°C

Temperatura Celsius përcaktohet si diferencë $t = T - T_0$ ndërmjet dy temperaturave termodinamike T dhe T_0 , ku $T_0 = 273,15$ K.

Një interval ose diferencë temperaturash mund të shprehet në kelvin ose në gradë celsius.



Tabela nr. 2

NJËSI TË RRJEDHURA NGA NJËSITË BAZË TË SISTEMIT SI

Njësi të rrjedhura të SI-së

Madhësia e rrjedhur	Njësia e rrjedhur	Simboli
- Sipërfaqja	metër katror	m ²
- Vëllimi	metër kub (a)	m ³
- Shpejtësia	metër për sekondë	m/s
- Nxitimi	metër për sekondë në katror	m/s ²
- Numri i valëve	një për metër	m ⁻¹
- Densiteti	kilogram për metër kub	kg/m ³
- Vëllimi specifik	metër kub për kilogram	m ³ /kg
- Densiteti i rrymës	amper për metër katror	A/m ²
- intensiteti i fushës magnetike	amper për metër	A/m
- përqendrimi (i sasisë së lëndës)	mol për metër kub	mol/m ³
- shkëlqimi	kandela për metër katror	cd/m ²
- indeksi i thyerjes	një (numër)	1
- aktiviteti katalitik	katal	kat= mol/s

a) Simboli “1” zakonisht nuk përdoret në kombinime me vlerën numerike.

b) Njësitë e rrjedhura formohen nga shprehjet algjebrike, që përmbajnë veprime të shumëzimit dhe të ngritjes në fuqi të njësive bazë SI dhe të shumëzuara këto me një koeficient të barabartë me 1.

Tabela nr. 3

NJËSI TË RRJEDHURA TË SI-SË, ME EMRA DHE SIMBOLE TË VEÇANTA

Madhësia e rrjedhur	Njësia		Shprehja	
	Emri	Simboli	E shprehur në njësi të tjera të SI	E shprehur në njësi bazë të SI
Këndi plan	radian ^(a)	rad		m · m ⁻¹
Këndi në hapësirë	steradian	sr		m ² · m ⁻²
Frekuenca	herz	Hz		s ⁻¹
Forca	njuton	N		m · kg · s ⁻²
Presioni, sforsimi	paskal	Pa	N/m ²	m ⁻¹ · kg · s ⁻²
Energjia, puna	xhaul	J	N · m	m ² · kg · s ⁻²
Fuqia ⁽¹⁾ , fluksi energjetik	wat	W	J/s	m ² · kg · s ⁻³
Ngarkesa elektrike	culon	C		s · A
Diferenca e potencialit elektrik, Forca elektromotore	volt	V	W/A	m ² · kg · s ⁻³ · A ⁻¹
Rezistenca elektrike	ohm	Ω	V/A	m ² · kg · s ⁻³ · A ⁻²
Përcjellshmëria	siemen	S	A/V	m ⁻² · kg ⁻¹ · s ³ · A ²
Kapaciteti	farad	F	C/V	m ⁻² · kg ⁻¹ · s ⁴ · A ²
Fluksimagnetik	weber	Wb	W · s	m ² · kg · s ⁻² · A ⁻¹
Densiteti i fluksit magnetik	tesla	T	Wb · m ⁻²	kg · s ⁻² · A ⁻¹
Induktiviteti	henri	H	Wb · A ⁻¹	m ² · kg · s ⁻² · A ⁻²
Fluksi i dritës	lumen	lm	cdsr	cd
Ndriçimi	lux	lx	lm/m ²	m ⁻² · cd
Aktiviteti i një burimi radioaktiv	bekerel	Bq		s ⁻¹
Doza e përthithur, energjia specifike, indeksi i dozës së absorbuar	grej	Gy	J/kg	m ² · s ⁻²
Doza ekuivalente	sivert	Sv	J/kg	m ² · s ⁻²
Aktiviteti katalitik	katal	kat		mol · s ⁻¹

Në veçanti, njësitë SI të prejardhura mund të shprehen me emra të veçantë dhe simbole të dhëna në tabelën e mësipërme; për shembull, njësia SI e viskozitetit dinamik mund të shprehet si m – 1 • kg • s – 1 ose N • s • m – 2 ose Pa • s.

(1)Emra të veçantë për njësinë e fuqisë: emri volt–amper (simboli “VA”), kur përdoret për të shprehur fuqinë e plotë të rrymës elektrike alternative, dhe var (simboli “var”), kur përdoret për të shprehur fuqinë elektrike reaktive. “var” nuk përfshihet në “GCPM resolutions”.



Tabela nr. 4

SHËMBUJ TË NJËSIVE TË RRJEDHURA SI, EMRAT DHE SIMBOLET E TË CILAVE SHPREHEN NGA KOMBINIMI I NJËSIVE TË RRJEDHURA TË SISTEMIT NDËRKOMBËTAR TË NJËSIVE (SI) ME EMRA DHE SIMBOLE TË VEÇANTA

Njësi të rrjedhura të SI

Njësia e rrjedhur	Emri	Simboli	Shprehur në terma të njësive bazë SI
- Viskoiziteti dinamik	paskal sekond	Pa.s	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-1}$
- Momenti i forcës	njuton metër	N.m	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}$
- Tensioni sipërfaqësor	njuton për metër	N/m	$\text{kg}.\text{s}^{-2}$
- Shpejtësia këndore	radian për sekondë	rad/s	$\text{m}.\text{m}^{-1}.\text{s}^{-1} = \text{s}^{-1}$
- Nxitimi këndor	radian për sekondë katror	rad/ s ²	$\text{m}.\text{m}^{-1}.\text{s}^{-1} = \text{s}^{-2}$
- Densiteti i fluksit termik, Rrezatimi energjetik	vat për metër katror	W/.m ²	$\text{kg}.\text{s}^{-3}$
-Kapaciteti termik entropia specifike	xhaul për Kelvin	J/K	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{K}^{-1}$ $\text{m}^2.\text{s}^{-2}$
- Energjia specifike	xhaul për kilogram	J/kg	
- Përcjellshmëria termike	vat për metër kelvin	W/(m.K)	$\text{m}.\text{kg}.\text{s}^{-3}.\text{K}^{-1}$
- Energjia vëllimore	xhaul për metër kub	J/ m ³	$\text{m}^{-1}.\text{kg}.\text{s}^{-2}$
- Intensiteti i fushës elektrike	volt për metër	V/m	$\text{m}.\text{kg}.\text{s}^{-1}.\text{A}^{-1}$
- Ngarkesa elektrike vëllimore	kulon për metër kub	C/ m ³	$\text{m}^{-3}.\text{s}.\text{A}$
- Induksioni elektromagnetik	kulon për metër katror	C/ m ²	$\text{m}^{-3}.\text{s}.\text{A}$
- Përcjellshmëria dielektrike	farad për metër	F/m	$\text{m}^{-3}.\text{kg}^{-1}.\text{s}^4.\text{A}^2$
- Përcjellshmëria magnetike	henri për metër	H/m	$\text{m}.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{A}^{-2}$
- Energjia molare	xhaul për mol	J/m	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{mol}^{-1}$
- Entropia molare kapaciteti termik molar	xhaul për mol kelvin	J/(mol.K)	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{K}^{-1}.\text{mol}^{-1}$
- Ekspozimi ndaj rrezeve	kulon për kilogram	C/kg	$\text{kg}^{-1}.\text{s}.\text{A}$
- Fuqia e dozës së absorbimit	grej/s	Gy/s	$\text{m}^2.\text{s}^{-3}$
- Intensiteti i rrezatimit	Vat për steradian	W/sr	$\text{m}^4.\text{m}^{-2}.\text{kg}.\text{s}^{-3}$
- Luminishenca energjetike	Vat për metër katror steradian	W(m ² .sr)	$\text{m}^2.\text{m}^{-2}.\text{kg}.\text{s}^{-3} = \text{kg}.\text{s}^{-3}$

Tabela nr. 5

SHUMËFISHAT DHE NËNFISHAT DHJETORË TË NJËSIVE TË MATJES TË SISTEMIT SI

Shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive formohen me anë të shumëzimit të faktorëve numerikë dhjetorë, me njësi të SI-së.

Faktorët numerikë tregohen me prefikse ose simbole të tyre, që vendosen para emrit të njësisë ose simbolit të tyre.

Faktori	Prefiksi	Simboli
10 ²⁴	jota	Y
10 ²¹	zeta	Z
10 ¹⁸	eksa	E
10 ¹⁵	peta	P
10 ¹²	tera	T
10 ⁹	giga	G
10 ⁶	mega	M
10 ³	kilo	k



10^2	hekto	h
10	deka	da
10^{-1}	deci	d
10^{-2}	centi	c
10^{-3}	mili	m
10^{-6}	mikro	μ
10^{-9}	nano	n
10^{-12}	piko	p
10^{-15}	femto	f
10^{-18}	ato	a
10^{-21}	zepto	z
10^{-24}	jokto	y

Tabela nr. 6

NJËSITË QË JANË CAKTUAR NË BAZË TË SISTEMIT TË NJËSIVE SI, POR NUK JANË SHUMËFISHA APO NËNFISHA DHJETORË TË TYRE

Madhësia	Njësia		
	Emri	Simboli	Vlera
Këndi plan	rrotullim *		1 rrotullim = 2π rad
	gradë* ose gon*	gon*	$1 \text{ gon} = \frac{\pi}{200} \text{ rad}$
	gradë	°	$1 = \frac{\pi}{180} \text{ rad}$
	Minutë këndore	'	$1' = \frac{\pi}{10\,800} 10\,800 \text{ rad}$
	Sekondë këndore	"	$1 = \frac{\pi}{648\,000} 648\,000 \text{ rad}$
Koha	minutë	min	1 min = 60 s
	orë	h	1 h = 3 600 s
	ditë	d	1 d = 86 400 s
(1) Karakteri (*) mbas një emri njësie ose simboli tregon se nuk figuron në listat e hartuara nga CGPM-ja, CIPM-ja ose BIPM-ja. Kjo vlen për të gjithë këtë shtojcë. (2) Asnjë simbol ndërkombëtar nuk ekziston.			

Shënim. Prefikset e paraqitura në tabelën 5 do të përdoren me njësitë dhe simbolet e masës, të vëllimit, të presionit në ajër e në lëngje dhe të njësisë gradë të këndit plan të tabelës nr. 6, me përjashtim të simbolit “g”.



Tabela nr. 7

NJËSITË E PËRDORURA ME SISTEMIN SI, VLERAT E TË CILAVE JANË PËRCAKTUAR EKSPERIMENTALISHT

Madhësia	Njësia		
	Emri	Simboli	Përkufizime
Energjia	Elektrovolt	eV	Elektron volt është energjia kinetike e fituar nga kalimi i një elektroni për një ndryshim potenciali prej 1 volt në vakum.
Masa	Masa atomike e unifikuar	u	Njësiti e masës atomike të unifikuar janë të barabarta me 1/12 e masës së një atomi të nuklidit ^{12}C .

Tabela nr. 8(a)

NJËSITË LIGJORE TË MATJES, LEJUAR VETËM PËR PËRDORIME SPECIFIKE

Fusha e aplikimit	Njësia			
	Emri	Vlera e përafëruar		Simboli
Shenjat e trafikut rrugor, matja e distancës dhe e shpejtësisë	milje	1 milje =	1 609 m	mile
	jard	1 yd =	0,9144 m	yd
	këmbë	1 ft =	0,3048 m	ft
	inç	1 in =	$2,54 \times 10^{-2}$ m	in
Shpërndarja e birrës, mushtit, qumështit n1% kontejnerë të kthyeshëm	pint	1 pt =	$0,5683 \times 10^{-3} \text{ m}^3$	pt
Transaksioni në metale të çmuara	troy ounce	1 oz tr =	$31,10 \times 10^{-3} \text{ kg}$	oz tr

Tabela nr. 8(b)

NJËSITË LIGJORE TË MATJES MADHËSITË, EMRAT, SIMBOLET DHE VLERAT E PËRAFËRTA

Gjatësia		
inç	1 in	$= 2,54 \times 10^{-2} \text{ m}$
këmbë	1 ft	$= 0,3048 \text{ m}$
milje	1 mile	$= 1 609 \text{ m}$
jard	1 jard	$= 0,9144 \text{ m}$
Sipërfaqja		
këmbë në katror	1 sq ft	$= 0,929 \times 10^{-1} \text{ m}^2$
akre	1 ac	$= 4 047 \text{ m}^2$
jard në katror	1 sq yd	$= 0,8361 \text{ m}^2$
Volumi		
fluid ounce	1 fl oz	$= 28,41 \times 10^{-6} \text{ m}^3$
gllënjë	1 gill	$= 0,1421 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
pint	1 pt	$= 0,5683 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
kuart	1 qt	$= 1,137 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
gallon	1 gal	$= 4,546 \times 10^{-3} \text{ m}^3$
Mas		
ounce (shmangës)	1 oz	$= 28,35 \times 10^{-3} \text{ kg}$
troy ounce	1 oz tr	$= 31,10 \times 10^{-3} \text{ kg}$
paund	1 lb	$= 0,4536 \text{ kg}$
Energjia		
therm	1 therm	$= 105,506 \times 10^6 \text{ J}$



Tabela nr. 8(c)

NJËSITË E MATJES, LEJUAR VETËM PËR PËRDORIME SPECIFIKE

Fusha e aplikimit	Njësia			
	Emri	Vlera e përafëruar		Simboli
Navigimi detar	pash detar (fathom)	1 fm =	1,829 m	fm
Birrë, musht, limonada, ujë, lëngje frutash në kontejnerë të kthyeshëm	pint	1 pt =	$0,5683 \times 10^{-3} \text{ m}^3$	pt
	fluid ounce	1 fl oz =	$28,41 \times 10^{-6} \text{ m}^3$	fl. oz
pije	gllënjë	1 gill =	$0,142 \times 10^{-3} \text{ m}^3$	gill
Mallra të shitura me shumicë	ounce (shmangës)	1 oz =	$28,35 \times 10^{-3} \text{ kg}$	oz
	paund	1 lb =	0,4536 kg	lb
furnizim me gaz	therm	1 therm =	$105,506 \times 10^6 \text{ J}$	therm

VENDIM

Nr. 296, datë 11.5.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT SHOQËRUES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), DHE KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), MASAT SHOQËRUESE PËR REHABILITIMIN E HIDROCENTRALIT TË FIERZËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit), masat shoqëruese për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE E GRANTIT

SHOQËRUES E DATËS 28 JANAR 2022, NDËRMJET KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 2,000,000.00 EURO – MASAT SHOQËRUESE PËR REHABILITIMIN E HIDROCENTRALIT TË FIERZËS – BMZ – NR. 2019 70 573

PËRMBAJTJA

Neni

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
 2. Kanalizimi i Grantit tek Agjencia e Zbatimit të Projektit
 2. Disbursimi
 3. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja
 4. Kostot dhe tarifat publike
 5. Deklaratat kontraktuale dhe kompetencat e përfaqësimit
 6. Shërbimet e ekspertit
 7. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Projektin
 8. Dispozita të ndryshme
- Zotimet e Përputhshmërisë të Marrësit
Zotimet e Pajtushmërisë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit

Në bazë të marrëveshjes së datës 27 janar 2021, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Financiar (Marrëveshja Qeveritare), Marrësi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të Grantit (Marrëveshja);



Kjo Marrëveshje është pjesë e projektit të rehabilitimit elektromekanik të hidrocentralit të Fierzës (Projekti). Projekti do të financohet me anë të kësaj Marrëveshjeje të Grantit Shoqërues, Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja e Huas) dhe Marrëveshjes së Grantit të financuar nga Fondi i Përbashkët Evropian i Bashkimit Evropian (Marrëveshja e Grantit dhe e Projektit të BE-së), të gjitha të së njëjtës datë me këtë marrëveshje.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një grant që nuk tejkalon 2.000,000.00 (me fjalë: dy milionë euro) (Granti).

Ky Grant financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi kanalizon Grantin plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit përdor Grantin ekskluzivisht për shërbimet e ekspertit për Projektin (Shërbimet e Ekspertit) dhe kryesisht për të paguar kostot e këmbimit të huaj. Detajet dhe objekti i Shërbimeve të Ekspertit që duhet të financohen nga Granti do të përcaktohen me një Marrëveshje të Veçantë, që do të nënshkruhet nga Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW dhe do të nënshkruhet, gjithashtu, si e lexuar dhe e pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfaqëson Marrësin (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW përcaktojnë në detaje kontributet plotësuese që duhet të jepen nga Agjencia për Zbatimin e Projektit në Marrëveshjen e Veçantë, që do të nënshkruhet si e lexuar dhe e pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfaqëson Marrësin. Agjencia e Zbatimit të Projektit jep kontributet e saj plotësuese plotësisht dhe në kohën e duhur. Agjencia e Zbatimit të projektit i jep KfW-së me kërkesë dëshmi që tregojnë masat e marra në këtë drejtim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Granti.

Neni 2

Kanalizimi i Grantit tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi kanalizon Grantin tek Agjencia e Zbatimit të Projektit, si një grant jo të shlyeshëm, të dhënë sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para fillimit të disbursimit nga Granti, Marrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes mbi huadhënien, të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Grantit nuk përbën ndonjë përgjegjësi të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin në përputhje me progresin e Shërbimeve të Ekspertit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me anë të Marrëveshjes së Veçantë, që, gjithashtu, do të nënshkruhet si e lexuar dhe e pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfaqëson Marrësin, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.3 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 mars 2028.

Neni 4.

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, nëse:

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje, janë shkelur;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë që Granti është përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së, sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) Marrëveshja e Huas ose e Granti dhe Marrëveshja e Projektit e BE-së nuk ka hyrë në



fuqi, ose një ngjarje ka ndodhur që lejon KfW të pezullojë disbursimet, në përputhje me ndonjë nga marrëveshjet e sipërpërmendura; ose

f) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertit.

4.2 KfW-ja mund të kërkojë pagesën e menjëhershme të Grantit nëse ndonjë prej situatave të specifikuar në nenin 3.1(b), (c) dhe (d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë. Në rastin e përcaktuar në nenin 3.1(c), shlyerja kufizohet në shumën të tilla që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që bëhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që lindin, në lidhje me disbursimin e Grantit.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe fuqia e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë përfaqëson Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrime model të vërtetuara prej tij ose saj, do të përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tij të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese, në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, bëhen me shkrim. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj

Marrëveshjeje që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë, sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)

Për Marrësin: Republika e Shqipërisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH)

Blloku “Vasil Shanto”

1001 Tiranë, Shqipëri

7. Shërbimet e Ekspertit

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të përgatisë dhe kryejë Shërbimet e Ekspertit, në përputhje me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e dakordësuar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertit dhe në këtë drejtim shfrytëzon shërbimet konsultuese të inxhinierëve të pavarur, të kualifikuar;

b) do të realizojë në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

c) do të mbajë ose do të sigurojë mbajtjen e librave dhe të regjistrave, që specifikojnë qartë të gjitha kostot e lindura në lidhje me Shërbimet e Ekspertit dhe që identifikojnë qartë shërbimet e financuara nga ky Grant financiar;

d) do të mundësojë për përfaqësuesit e KfW-së në çdo kohë librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me Shërbimet e Ekspertit;

e) do t'i japë KfW-së ndonjë dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertit dhe mbi ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së.

7.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet lidhur me Nenin 7.1 me një Marrëveshje të Veçantë; që do të nënshkruhet gjithashtu si e lexuar dhe e pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që përfaqëson Marrësin.

7.3 Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) do të sigurojnë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertit dhe i japin KfW-së me kërkesë dëshmi që tregojnë se janë mbuluar kostot e papaguara nga ky Grant;

b) me porosi të tyre do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit;

7.4 Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me praktikën e shëndosha inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, do t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e domosdoshme për zbatimin e Projektit.

Neni 8

Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Shërbimet e Ekspertit

8.1 Për të qenë në përputhje me parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për transparencë dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e kategorizimit dhe vlerësimit mjedisor dhe shoqëror, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas Projektit)) për Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa zbatohet (zbatohen) marrëveshja (marrëveshjet) lidhur me shërbimet e ekspertit dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit, për fushën e saj të biznesit, të Bankës për Zhvillim të KfW-së (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta) në përputhje me nenin 8.3 më poshtë, në lidhje me Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre, nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të detajuar sensitiv financiar ose biznesi, në lidhje me palët e përfshira në Projekt ose financimin e tij, të tilla si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategji biznesi;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhënat personale të personave fizikë;

e) vlerësimin e brendshëm të KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën se si është financuar gjatë Periudhës së Plotë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëshënuara:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, në veçanti, Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) palët në Kushtet e Përgjithshme të datës 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (FPEBP);

f) institucionet që administrojnë FPEBP-në;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij;

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën se si financohet gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, që publikojnë seksionet që lidhen me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Iniciativës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakten/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html);



b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI), për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) palët në Kushtet e Përgjithshme të datës 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (FPEBP);

f) institucionet që administrojnë FPEBP-në;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.4 KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion, në lidhje me Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin, që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Marrësit ose të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore ose për të pohuar ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën (Zotimet e Përputhshmërisë së Marrësit). Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 1b (Zotimet e Përputhshmërisë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në

lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 As Marrësi dhe as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të delegojë ose transferojë, rendojë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përbushjes është Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo Marrëveshje midis KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit të krijuara me anë të kësaj Marrëveshjeje do të përfundojnë 6 muaj pas disbursimit përfundimtar.

9.6 Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën që KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim nga Marrësi që procedurat e brendshme që duhet të përbushen nga Marrësi kanë përfunduar (data e marrjes tek KfW-ja).

Hartuar në 3 (tri) origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
sot më 28 janar 2022
KfW

Emri: Brit Horschke
Pozicioni: Drejtori KfW i
vendit Shqipëri

Emri: Sarah Borgard
Pozicioni: Manaxheri
Kryesor i Portofolit

Tiranë,
sot më 28 janar 2022

Republika e Shqipërisë, e
përfaqësuar nga Ministria e
Financave dhe Ekonomisë

Emri: Delina Ibrahimaj
Pozicioni: Ministër i
Financave dhe Ekonomisë

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
(KESH)

Emri: Ergys Verdho
Pozicioni: Administrator i KESH sha

Shtojca

Shtojca 1a: Zotimet e Përputhshmërisë të Marrësit

Shtojca 1b: Zotimet e Përputhshmërisë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit



SHTOJCA 1a
ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË
TË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo për të lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmimeve të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.

“Person”, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

“Praktikë e sanksionueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë

korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksione”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Marrësi, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Marrësin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Marrësin, që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese



apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Projektin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Marrësit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Marrësit për projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë të Pagesës së Interesit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, sapo Marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash, apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Marrësi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Projektin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 2b

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTT

1. PËRKUFIZIMET

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim për të dëmtuar apo për të lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë person apo pronë të personit për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi;

“Praktikë e fshehtë”, një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

“Praktikë korruptive”, premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i

ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e ndonjë personi për të vepruar.

“Kategoritë e përcaktuara të veprave penale”, kategoritë e mëposhtme të veprave penale, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimit përkatës interpretues: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera; korrupsioni dhe mitëmarrja/mitëdhënia; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme me forcë dhe pengmarrja; grabitja ose vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat dhe tarifatat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (të lidhura me taksat direkte dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

“Rekomandimet e FATF-së”, rekomandime të tilla që përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF-ja është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilës është hartimi dhe nxitja e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e marrjes së një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

“Origjinë e paligjshme”, origjina e fondeve të përfutuara me anë të:

- ndonjë veprë penale të listuar në Kategoritë e Caktuara të Veprave Penale;
- ndonjë praktike korruptive;
- ndonjë praktike mashtruese; ose
- pastrimit të parave.



“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim i synuar për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet e një Praktikë Korruptive, Mashtruese, Shtrënguese ose të Fshehtë.

“Person”, çdo person fizik, person juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

“Praktikë e sanksionueshme”, çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksionet”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike, që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA NË LIDHJE ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe të ndonjë (në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë) aksionari, filiali dhe/ose bashkëpunëtori tjetër të tij (nëse ka), siç KfW-ja mund të kërkojë;

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj inspektimin në çdo kohë të të gjithë dokumentacionit tjetër të lidhur me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

f) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë ose personave apo subjekteve të bllokuar, të renditur në ndonjë lloj Liste Sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet.

b) Në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të



Projektit, as fondet e investuara në Projekt nuk kanë Burim të Paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, bashkëpunëtorët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i. ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuar të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk ii. është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje Huaje dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit, duke iu referuar rrethanave mbizëtoruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, për të përcaktuar, nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë Burim të Paligjshëm;

b) sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të

veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

VENDIM

Nr. 5, datë 21.3.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të neneve 21/3 dhe 21/5 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 21–23.3.2022, si më poshtë:

- 216 lekë/litri për gazoilin;
- 199 lekë/litri për benzinën.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 22–23.3.2022, si më poshtë:

- 221 lekë/litri për gazoilin;
- 211 lekë/litri për benzinën;
- 93 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar.

4. Ky vendim për miratimin e çmimeve tavan, sipas pikës 1, i fillon efektet më datë 21.3.2022, ndërsa çmimet tavan të miratuara sipas pikës 2 të këtij vendimi i fillojnë efektet më datë 22.3.2022.



5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM

Nr. 6, datë 23.3. 2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të neneve 21/3 dhe 21/5 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 23–25.3.2022, si më poshtë:

- 227 lekë/litri për gazoilin;
- 208 lekë/litri për benzinën.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 23–25.3.2022, si më poshtë:

- 233 lekë/litri për gazoilin;
- 218 lekë/litri për benzinën;
- 93 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’” .

4. Ky vendim për miratimin e çmimeve tavan, sipas pikave 1 dhe 2, i fillon efektet sot më datë 23.3.2022, ora 15:00.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM

Nr. 7, datë 25.3.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të neneve 21/3 dhe 21/5 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 26–28.3.2022, si më poshtë:

- 227 lekë/litri për gazoilin;
- 208 lekë/litri për benzinën.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 26–28.3.2022, si më poshtë:

- 233 lekë/litri për gazoilin;
- 218 lekë/litri për benzinën;
- 93 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe



tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

4. Ky vendim për miratimin e çmimeve tavan, sipas pikave 1 dhe 2, i fillon efektet më datë 26.3.2022 deri më datë 28.3.2022.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM

Nr. 8, datë 29.3.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe të nenit 21/5 të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 29–31.3.2022, si më poshtë:

- 225 lekë/litri për gazoilin;
- 199 lekë/litri për benzinën.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 29–31.3.2022, si më poshtë:

- 237 lekë/litri për gazoilin;
- 211 lekë/litri për benzinën;
- 116 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit,

Faqe/9332

në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, dhe nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar.

4. Efektet e këtij vendimi fillojnë sot më datë 29.3.2022, ora 11:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM

Nr. 9, datë 31.3.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe të nenit 21/5 të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve për datën 1.4.2022 deri më datë 4.4.2022, si më poshtë:

- 219 lekë/litri për gazoilin;
- 200 lekë/litri për benzinën;
- 103 lekë /litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve për datën 1.4.2022 deri më datë 4.4.2022, si më poshtë:

- 231 lekë/litri për gazoilin;
- 212 lekë/litri për benzinën;



- 115 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë për gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai, si lëndë djegëse për motor automjesh në vlerën 105 lekë/litri.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënprodukte të naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, dhe nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar.

5. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 1.4.2022, ora 8:00 deri më datë 4.4.2022.

6. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM

Nr. 10, datë 1.4.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, dhe të nenit 21/5 të aktit normative nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve duke filluar nga data 2.4.2022, si më poshtë:

- 214 lekë/litri për gazoilin;

- 196 lekë/litri për benzinën;

- 102 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve duke filluar nga data 2.4.2022, si më poshtë:

- 226 lekë/litri për gazoilin;

- 208 lekë/litri për benzinën;

- 114 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 2.4.2022, ora 6:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënprodukte të naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022 dhe nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar.

5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi

VENDIM

Nr. 11, datë 5.4.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe të nenit 21/5 të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre’”, të ndryshuar,



VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:

- 221 lekë/litri për gazoilin;
- 197 lekë/litri për benzinën;
- 103 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.

2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:

- 233 lekë/litri për gazoilin;
- 209 lekë/litri për benzinën;
- 115 lekë /litri për gazin e lëngshëm të naftës.

3. Efektet e këtij vendimi fillojnë sot më datë 5.4.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.

